



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

*Nr.04/2023*  
*Data: 22.11.2023*

## **THIRRJE PUBLIKE**

### ***PËR MBËSHTETJEN E NDËRMARJEVE MIKRO TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM), NË INVESTIMIN NË PAJISJE EFIÇIENTE PËR NGROHJE***

*Që nga viti 2021, kriza energjetike nëpër të cilën po kalon Evropa ka përkeqësuar situatën me furnizim të qëndrueshëm me energji edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të prodhimit të brendshëm të energjisë, varësia nga importi dhe çmimet jostabile të energjisë në tregun ndërkombëtar, rëniet e tensionit dhe probleme tjera të rrjetit krijojnë pasiguri në furnizimin me energji. Një situatë e tillë vlerësohet që pengon edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës, duke shkaktuar rrjedhimisht kosto të larta për ekonomitë familjare e bizneset.*

*Ulja e konsumit përmes rritjes së Eficiencës së Energjisë (EE), ndikon në reduktimin e kërkesës për energji, e cila vazhdon të rritet dukshëm në Republikën e Kosovës gjatë sezonit së dimrit dhe ngrohjes, duke qenë se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve, në mungesë të alternativave tjera, përdorin energjinë elektrike për ngrohje.*

*Qeveria e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh këtë situatë të paqëndrueshme të furnizimit me energji, ka ndërmarrë masa konkrete në*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

*adresimin e saj. Në linjë sipas Vendimit<sup>1</sup> Nr. 29/112, datë 13.12.2022, i plotësuar me Vendimin<sup>2</sup> Nr.03/128, datë 16.02.2023, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin e Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike në shumë prej shtatëdhjetë e pesë (75) milionë euro, si parakusht për përfitimin e mjeteve financiare nga Bashkimi Evropian (BE) për Programin Vjetor IPA 2023. Ky plan parasheh zbatimin e masave me efekte të menjëhershme dhe afatshkurta për periudhën e dimrit, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për familjet në nevojë dhe në disavantazh social, nxitjen e kursimit të energjisë nga konsumatorët familjarë, mbështetjen e familjeve përmes rritjes së Eficiencës së Energjisë (EE) në njësitë e banimit dhe të ndërtesave si dhe investimeve në pajisje efikente dhe sisteme të energjisë së ripërtëritshme për familjet dhe Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM).*

*Bazuar në Masën 5 të Planit të Veprimit për Zbutjen e Ndikimit të Menjëhershëm Socio-Ekonomik të Krizës Energjetike, Ministria e Ekonomisë (ME), shpall Thirrje Publike për mbështetjen e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në investimin në pajisje efikente për ngrohje, duke përfshirë si në vijim:*

- ✓ *Pompë termike;*
- ✓ *Kondicioner/klimë efikente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikencë të lartë);*
- ✓ *Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket);*
- ✓ *Stufa individuale me biomasë.*

---

<sup>1</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>

<sup>2</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30>



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

## **1. PAJISJET TË CILAT DO TË SUBVENCIONOHEN PËR NDËRMARRJET MIKRO TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM-të)<sup>3</sup>**

Për t'u kualifikuar për subvencionim, ndërmarrja juaj duhet të jetë Mikro, e Vogël apo e Mesme sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja:

- Ndërmarrje Mikro (të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë<sup>4</sup>);
- Ndërmarrje e Vogël (të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzet e nëntë (49) punëtorë);
- Ndërmarrje e Mesme (të ketë të punësuar prej pesëdhjetë (50) deri dyqind e dyzet e nëntë (249) punëtorë).

Subvencionohet vetëm blerja e pajisjeve të reja eficiente për ngrohje për zëvendësim të atyre joeficiente<sup>5</sup>.

Qëllimi i skemës është ulja e konsumit të energjisë në përgjithësi dhe në veçanti ulja e shpenzimit të energjisë elektrike, rrjedhimisht ju mund të aplikoni për pajisje eficiente elektrike vetëm nëse aktualisht ju ngrohni me pajisje joeficiente elektrike, ndërsa për pajisje eficiente me biomasë mund të aplikojnë të gjithë.

Secili aplikues gëzon të drejtën e përfitimit të subvencionit për vetëm një (1) nga pajisjet e cekura më poshtë, për biznes.

- ✓ Pompë termike;
- ✓ Kondicioner/klimë (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë);
- ✓ Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket);

<sup>3</sup> Sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja.

<sup>4</sup> Numri i punëtorëve për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) verifikohet direkt nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe llogaritet si numri mesatar i punëtorëve për periudhën 1 shtator 2022 - 31 gusht 2023.

<sup>5</sup> Me pajisje joeficiente nënkuptohet çdo pajisje që përdorë njëqind për qind (100%) energji elektrike për ngrohje me rezistencë direkte, si: sisteme për ngrohje dhe ftohje që nuk i takojnë grupit me inverter, trion, kalorifer. Kurse, kaldaja me biomasë konsiderohet joeficiente nëse shkalla e shfrytëzimit është më e ulët se sa kriteri i vendosur në thirrje.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

✓ Stufa individuale me biomasë.

Përfituesi i subvencionit merr obligim që në hyrje të ndërtesës së biznesit (në një pozitë të dukshme) të vendosë një etiketë njoftuese (stiker) se është përfitues i subvencionit për efikasitet të energjisë, të cilën do ta pranojë nga Ministria e Ekonomisë (ME). Të gjithë përfituesit e subvencionit do të njoftohen me kohë dhe pajisen me etiketë njoftuese (stiker) nga ana e Ministrisë.

## 2. KRITERET TEKNIKE DHE TË PËRGJITHSHME

Në tabelën më poshtë mund të gjeni kriteret për aplikim, kriteret teknike, vlerën e subvencionit dhe sqarimet shtesë për secilën prej pajisjeve që do të subvencionohen.

**Tabela 1.0**

PAJISJA	KRITERET PËR APLIKIM	KRITERET TEKNIKE TË PAJISJES	VLERA E SUBVENCIONIMIT	SQARIME SHITESË
<b>Pompë termike me kapacitet deri në 35kW</b> (ngarkesës për ngrohje).	a. Ndërtesa juaj ngrohet me energji elektrike (konsumi mesatar i energjisë elektrike për tre (3) muaj - dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023,	a. Shkalla e performancës/efikasitetit të energjisë të jetë minimum A++. b. Të plotësojë një nga kriteret	Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është njëzet përqind (20%) e vlerës investive dhe deri në <b>2000.00 €</b> .	Subvencionimi përfshin vetëm vlerën investive për blerjen e pajisjes dhe jo pjesët përcjellëse.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	<p><i>duhet të jetë së paku 1000 kWh), dhe</i></p> <p>Fatura e energjisë elektrike gjatë dimrit, konsumi mesatar për muajt dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, duhet të jetë së paku njëzet e pesë përqind (25%) më e madhe sesa njëri nga muajt maj ose shtator 2023.</p> <p>b. Ndërtesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>c. Ndërtesa juaj është e termoizoluar<sup>6</sup>.</p> <p>d. Ndërtesa juaj ka të instaluar sistemin qendror të ngrohjes (<i>rrjetin e</i></p>	<p>e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Koeficienti i performancës së pompës termike (COP) të jetë 4.2 ose më i lartë, ose;</li><li>▪ Koeficienti i performancës sezonale (SCOP) të jetë 3.2 ose më i lartë.</li></ul> <p>c. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.</p>	<p>Për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave<sup>9</sup> nga pesëdhjetë e një përqind (51%) e tutje, vlera e subvencionimit është njëzet e pesë përqind (25%) e vlerës investive dhe deri në <b>2000.00 €</b>.</p>	
--	---	--	--	--

<sup>6</sup> Mbështjellësi i jashtëm i ndërtesës: Muret e jashtme të ndërtesës duhet të jenë të izoluara termikisht (p.sh stitopor, lesh guri) dhe dritaret e dyert e jashtme të jenë në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami.

<sup>9</sup> Vlen vetëm për bashkëpronarët që janë persona fizik.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	<p><i>brendshëm të ngrohjes).</i></p> <p>e. Biznesi juaj duhet të jetë aktiv<sup>7</sup>.</p> <p>f. Qarkullimi neto<sup>8</sup> për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit (shtator 2022 - gusht 2023) duhet të jetë pozitiv.</p> <p>g. Biznesi juaj nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në.</p>			
<p><b>Pompë termike me kapacitet mbi 35kW deri në 135kW</b>(ngarkesës për ngrohje).</p>	<p>a. Ndërtesa juaj ngrohet me energji elektrike (<i>konsumi mesatar i energjisë elektrike për tre (3) muaj - dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, duhet të jetë së paku 1000 kWh</i>);</p>	<p>a. Shkalla e performancës/eficiencës të energjisë të jetë minimum A.</p> <p>b. Të plotësojë një nga kriteret e mëposhtme:</p>	<p>Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është njëzet përqind (20%) e vlerës investive dhe deri në <b>2000.00 €</b>.</p>	<p>Subvencionimi përfshin vetëm vlerën investive për blerjen e pajisjes dhe jo pjesët përcjellëse.</p>

<sup>7</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.

<sup>8</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	<p><b>dhe</b></p> <p>Fatura e energjisë elektrike gjatë dimrit, konsumi mesatar për muajt dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, duhet të jetë së paku njëzet e pesë përqind (25%) më e madhe sesa njëri nga muajt maj ose shtator 2023.</p> <p>b. Ndërtesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>c. Ndërtesa juaj është e termoizoluar<sup>10</sup>.</p> <p>d. Ndërtesa juaj ka të instaluar sistemin qendror të ngrohjes (<i>rrjetin e brendshëm të ngrohjes</i>).</p>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Koeficienti i performancës së pompës termike (COP) të jetë 3.2 ose më i lartë, ose;</li><li>▪ Koeficienti i performancës sezonale (SCOP) të jetë 3.0 ose më i lartë.</li></ul> <p>c. E pajisur me etiketën e konformitetit CE.</p>		
--	---	--	--	--

<sup>10</sup> Mbështjellësi i jashtëm i ndërtesës: Muret e jashtme të ndërtesës duhet të jenë të izoluara termikisht (p.sh stitopor, lesh guri) dhe dritaret/dyert e jashtme të jenë në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	<p>e. Biznesi juaj duhet të jetë aktiv<sup>11</sup>.</p> <p>f. Qarkullimi neto<sup>12</sup> për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit (shtator 2022 - gusht 2023) duhet të jetë pozitiv.</p> <p>g. Biznesi juaj nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në.</p>			
<b>Kondicioner/klimë efiçiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efiçiençë të lartë).</b>	<p>a. Ndërtesa juaj ngrohet me energji elektrike (<i>konsumi mesatar i energjisë elektrike për tre (3) muaj - dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, duhet të jetë së paku 1000 kWh</i>), <b>dhe</b></p>	<p>a. Shkalla e performancës/efiçiençës të energjisë të jetë minimum A+ (ngrohje).</p> <p>b. Koefficienti sezonal i performancës së kondicionerit/klimës</p>	<p>Vlera e subvencionimit për një (1) pajisje është njëzet përqind (20%) e vlerës investive dhe deri në <b>1000.00 €</b>.</p> <p>Për bizneset në pronësi</p>	<p>Subvencionimi përfshin vetëm vlerën investive për blerjen e pajisjes (me një njësi të jashtme dhe të brendshme apo sistem multisplit) dhe jo pjesët përcjellëse.</p>

<sup>11</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.

<sup>12</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	<p>Fatura e energjisë elektrike gjatë dimrit, konsumi mesatar për muajt dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, duhet të jetë së paku njëzet e pesë përqind (25%) më e madhe sesa njëri nga muajt maj ose shtator 2023.</p> <p>b. Ndërtesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>c. Ndërtesa juaj ka njërën nga masat e efijencës së energjisë (të ketë muret e jashtme të izoluara termikisht apo t'i ketë dyert/dritaret e jashtme në gjendje të mirë teknike dhe fizike dhe së paku të jenë me dy shtresa xhami</p>	<p>(<b>SCOP</b>) të jetë 4.0 ose më i lartë.</p> <p>c. Të pajisur me markën e konformitetit CE.</p>	<p>apo në bashkëpronësi të grave<sup>15</sup> nga pesëdhjetë e një përqind (<b>51%</b>) e tutje, vlera e subvencionimit është njëzet e pesë përqind (<b>25%</b>) e vlerës investive dhe deri në <b>1000.00 €</b>.</p>	
--	--	---	---	--

<sup>15</sup> Vlen vetëm për bashkëpronarët që janë persona fizik



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	<p>ose në rast të sipërfaqeve të xhamëzuara, trashësia e xhamit të jetë së paku 6mm).</p> <p>d. Biznesi juaj duhet të jetë aktiv<sup>13</sup>.</p> <p>e. Qarkullimi neto<sup>14</sup> për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit (shtator 2022 - gusht 2023) duhet të jetë pozitiv.</p> <p>f. Biznesi juaj nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në.</p>			
--	---	--	--	--

<sup>13</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.

<sup>14</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

<b>Kaldaja me biomasa (dru, pelet, briket).</b>	<p>a. Për të dëshmuar se biznesi juaj është aktiv gjatë periudhës së dimrit kërkohet që konsumi mesatar i energjisë elektrike për tre (3) muaj - dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, të jetë së paku 150 kWh.</p> <p>b. Ndërtesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.</p> <p>c. Biznesi juaj duhet të jetë aktiv<sup>16</sup>.</p> <p>d. Qarkullimi neto<sup>17</sup> për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit (shtator 2022 - gusht 2023) duhet të jetë pozitiv.</p>	<p>a. Certifikatë që dëshmon se minimum shtatëdhjetë e pesë përqind (75%), (vlen për kaldajën me pelet dhe briket).</p> <p>b. Certifikatë që dëshmon se shkalla e shfrytëzimit është minimum gjashtëdhjetë përqind (60%), (vlen vetëm për kaldajën me dru me efikasitet të lartë).</p>	<p>Subvencionohet dyzet përqind (<b>40%</b>) e vlerës investive, dhe deri në <b>2000.00 €</b>.</p> <p>Për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave<sup>18</sup> nga pesëdhjetë e një përqind (<b>51%</b>) e tutje, vlera e subvencionimit është dyzet e pesë përqind (<b>45%</b>) e vlerës investive dhe deri në <b>2000.00 €</b>.</p>	<p>Subvencionimi përfshin vetëm vlerën investive për blerjen e pajisjes dhe jo pjesët përcjellëse.</p>
---	--	--	---	--

<sup>16</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.

<sup>17</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.

<sup>18</sup> Vlen vetëm për bashkëpronarët që janë persona fizik



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

	e. Biznesi juaj nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në.			
<b>Stufa individuale me biomasë.</b>	a. Për të dëshmuar se biznesi juaj është aktiv gjatë periudhës së dimrit kërkohet që konsumi mesatar i energjisë elektrike për tre (3) muaj - dhjetor 2022, janar dhe shkurt 2023, duhet të jetë së paku 150 kWh. b. Ndërtesa juaj nuk ka qasje në ngrohje të qytetit ose në ngrohje kolektive.	a. Për stufat individuale me biomasë nuk ka kriter teknik.	Subvencionohet dyzet përqind ( <b>40%</b> ) e vlerës investive, dhe deri në <b>500.00 €</b> . Për bizneset në pronësi apo në bashkëpronësi të grave <sup>21</sup> nga pesëdhjetë e një përqind ( <b>51%</b> ) e tutje, vlera e subvencionimit është dyzet e pesë përqind ( <b>45%</b> ) e vlerës	Subvencionimi përfshin vetëm vlerën investive për blerjen e pajisjes dhe jo pjesët përcjellëse. Nga ky subvencionim përjashtohet kamini montues.

<sup>21</sup> Vlen vetëm për bashkëpronarët që janë persona fizik.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by  
the European Union**

	<p>c. Biznesi juaj duhet të jetë aktiv<sup>19</sup>.</p> <p>d. Qarkullimi neto<sup>20</sup> për dymbëdhjetë (12) muajt e fundit (shtator 2022 - gusht 2023) duhet të jetë pozitiv.</p> <p>e. Biznesi juaj nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në.</p>		investive dhe deri në <b>500.00 €.</b>	
--	---	--	--	--

<sup>19</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.

<sup>20</sup> Ky kriter verifikohet automatikisht në e-Kosova, bazuar në të dhënat e ATK-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by  
the European Union**

### 3. MËNYRA E APLIKIMIT PËR SUBVENCION

Aplikimi për subvencionim është e ndarë në dy (2) faza, dhe në të dy (2) fazat aplikimi bëhet online përmes platformës e-Kosova. Ju duhet të posedoni llogari individuale apo të biznesit përmes së cilës platforma e-Kosova do të identifikojë bizneset në të cilat jeni pronar apo përfaqësues i autorizuar. Aplikimi mund të bëhet nga aksionari/ët apo personi i autorizuar nga kompania.

#### **Hapat për aplikim**

##### **Faza I**

1. Sigurohuni që plotësoni kriteret për aplikim të specifikuar në tabelën si më lart, në linkun në vijim: <https://rks-gov.net/476>
2. Nëse aplikimi juaj është i suksesshëm, ju do të njoftoheni menjëherë që jeni kualifikuar për këtë fazë në email adresën e juaj, dhe mund të vazhdoni me blerjen e pajisjes që keni përzgjedhur konform kriterëve teknike të specifikuar në thirrje. Linkun për aplikim në fazën e dytë do ta pranoni në email adresën me të cilën e keni hapur llogarinë e juaj në e-Kosova.

##### **Faza II**

Pas blerjes dhe instalimit të pajisjes eficiente për ngrohje, sipas kriterëve të specifikuar në thirrje, ju duhet të aplikoni për fazën II përmes platformës e-Kosova që të ju mundësohet përfitimi nga ky subvencion, duke ngarkuar dokumentet si në vijim:



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by  
the European Union**

- a. Faturën e rregullt me dëshmi të pagesës përmes transferit bankar apo kuponin fiskal të blerjes së pajisjes (data e blerjes duhet të jetë nga data e shpalljes së thirrjes më datë 22.11.2023);
- b. Fotografi të pajisjes së blerë dhe instaluar sipas kriterëve të specifikuar në thirrje (për kondicioner/klimë - pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë, fotografi e një njësie të jashtme dhe të brendshme apo të sistemit multisplit);
- c. Fotografi të numrit serik të pajisjes (nuk kërkohet për stufat individuale me biomasë);
- d. Fotografi të etiketës së konformitetit CE së pajisjes (opsionale për kaldajat dhe stufat individuale me biomasë);
- e. Fotografi të etiketës së performancës energjetike të pajisjes – etiketa e energjisë (nuk kërkohet për kaldajat dhe stufat individuale me biomasë);
- f. Fotografi të koeficientit të performancës së pajisjes (vlen për pompë termike dhe për kondicioner/klimë - pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikasitet të lartë), koeficientin e COP ose SCOP (ku është e aplikueshme);
- g. Fotografi të certifikatës që dëshmon shkallën e shfrytëzimit për kaldajën me biomasë;
- h. Dëshminë që kompania nuk ka asnjë detyrim ose borxh ndaj ATK-së apo është në marrëveshje të obligimeve tatimore me ATK-në;
- i. Marrëveshja juaj e subvencionimit do të gjenerohet automatikisht në platformën e-Kosova. Kjo marrëveshje duhet patjetër të shkarkohet, të nënshkruhet, dhe të ngarkohet së bashku me dokumentet e sipërpërmendura.
- j. Shkarkoni formularin nga platforma e-Kosova dhe me ndihmën e kompanisë instaluese/tregtare plotësoni formularin për aplikim “Shtojca 1” dhe pas plotësimit ngarkoni formularin në e-Kosova.

Në këtë fazë ju kërkohet të vendosni numrin e xhironlogarisë bankare të biznesit e cila duhet të jetë në emër të biznesit dhe nga ndonjëra prej bankave të licencuara brenda Republikës së Kosovës.

Pas ngarkimit të dokumenteve të listuara më lart në platformën online e-Kosova, ju do të pranoni një (1) njoftim automatik me përmbajtjen: *“Aplikimi juaj është realizuar me sukses dhe për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare”*.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

Aplikacioni juaj do të vlerësohet nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), i cili do të shqyrtojë nëse dëshmitë e ngarkuara në platformën e-Kosova janë konform kriterëve të kësaj thirrjeje. Për rezultatet e aplikimit do të njoftoheni sipas afateve zyrtare. Nëse aplikacioni juaj vlerësohet pozitivisht nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), ju do të njoftoheni përmes platformës e-Kosova dhe do të pranoni mjetet nga subvencioni në xhironlogari.

Inspektimi i pajisjeve të instaluara do të fillojë nga data **10 mars 2024**.

### **Afati për aplikim**

Afati i fundit për aplikim për fazën e parë është deri **më 31 janar 2024**, ose deri në shpenzimin e buxhetit të alokuar për këtë thirrje. Aplikimet e pranuar në fazën e parë do të shqyrtohen bazuar në parimin “**KUSH APLIKON I PARI, SHËRBEHET I PARI**”, andaj inkurajoheni të aplikoni sa më herët.

Ndërsa, afati i fundit për fazën e dytë është deri më datën **1 mars 2024**.

### **E drejta për ankesë**

Aplikantët të cilët vlerësojnë se aplikimi i tyre nuk është vlerësuar drejtë nga Komisioni përkatës i Ministrisë së Ekonomisë (ME), mund të ushtrojnë të drejtën e ankesës në afat **prej tridhjetë (30) ditësh**, nga dita e pranimit të njoftimit, konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA). Ankesa i drejtohet Ministrisë së Ekonomisë (ME), si autoritet që ka publikuar thirrjen në email adresën: [komisioni.ankesa@rks-gov.net](mailto:komisioni.ankesa@rks-gov.net)





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**

### **Sqarime shitesë**

Për më shumë informacione dhe sqarime shitesë, rreth fazave të aplikimit mund të drejtoheni me shkrim në email adresën: [info.subvencionet@rks-gov.net](mailto:info.subvencionet@rks-gov.net) apo të kontaktoni në numrat e telefonit si më poshtë:

☎ 038 200 215 89

☎ 038 200 215 55

Nga e hëna deri të premten, duke filluar nga ora: 08:30-12:00 dhe nga ora 13:00-16:00.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by  
the European Union**

### Shtojca 1: Formulari i aplikimit

TË DHËNAT E APLIKUESIT		
Emri i biznesit:		
Numri unik i biznesit (NUI):		
Numri i njësisë së biznesit ku do të instalohet pajisja: (për bizneset që kanë disa njësi)		
Adresa e njësisë së biznesit ku do të instalohet pajisja:		
Vendi:		
Telefoni:		
E-mail adresa:		
TË DHËNAT E MËPOSHTME TË PLOTËSOHEN NGA INSTALUESI/TREGTARI		
Të dhënat e pajisjes për ngrohje:		
Lloji i pajisjes Modeli: _____ Prodhuesi: _____	<input type="checkbox"/> Pompë termike me kapacitet deri në 35kW <sub>(ngarkesës për ngrohje)</sub> ; <input type="checkbox"/> Pompë termike me kapacitet mbi 35kW deri në 135kW <sub>(ngarkesës për ngrohje)</sub> ; <input type="checkbox"/> Kondicioner/klimë efiçiente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efiçencë të lartë); <input type="checkbox"/> Kaldaja me biomasë (dru, pelet, briket).	Kapaciteti: _____ kW (nuk kërkohet për stufë)



	<input type="checkbox"/> Stufa individuale me biomasë	
Të dhënat teknike (të plotësohet varësisht nga pajisja për të cilën është bërë aplikimi).	<input type="checkbox"/> COP: _____ <input type="checkbox"/> SCOP: _____ <input type="checkbox"/> Shkalla e shfrytëzimit (%): _____ <input type="checkbox"/> Shkalla e performancës: _____ <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet	
Hapësira ngrohëse sipas kapacitetet të pajisjes.	_____ m <sup>3</sup> (nuk kërkohet për stufë)	
Hapësira/sipërfaqja për ngrohje.	_____ m <sup>2</sup>	
Sistemi qendror me të cilën do të lidhet pajisja.	<input type="checkbox"/> ngrohje dyshemore <input type="checkbox"/> ngrohje me radiator <input type="checkbox"/> ngrohje/ftohje me ventilator konvektor (fan coils), tavanor, dyshemor ose parapeti <input type="checkbox"/> sistem i ventilimit qendror <input type="checkbox"/> nuk aplikohet [për stufë dhe kondicioner/klimë efikente (pompë termike ajër-ajër të tipit inverter me efikencë të lartë)]	
<b>Implementuesi dhe deklarata mbi standardet teknike</b>		
Emri i biznesit instalues/tregtari:		
Numri unik i biznesit (NUI):		
E-mail adresa:		
Numri i telefonit:		



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by  
the European Union**

Personi përgjegjës [Emri dhe mbiemri].	
Deklaroj se instalimi i pajisjes ngrohëse eficiente i përmbush të gjitha Standardet Teknike sipas thirrjes Nr.04/2023 të datës 22.11.2023.	<i>Vula dhe nënshkrimi i personit përgjegjës të autorizuar nga kompania instaluese/tregtare.</i>

Plotësimi i këtij formulari nënkupton autorizimin e institucionit që të përdorë të dhënat e përfshira në të për qëllime të këtij projekti!

**Vërejtje:** Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Neni 299 - Mashtrimi i blerësve “1. Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shenjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojnë për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

**Emri dhe mbiemri i aplikuesit:** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_ **Vendi:** \_\_\_\_\_



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*  
**Ministria e Ekonomisë**  
**Ministarstvo Ekonomije -Ministry of Economy**



**Funded by**  
**the European Union**